



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 5131 Prot.

Tiranë, më 14.8.2023

Lënda: Mbi regjistrimet në institucionet e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024

AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Rruga "Papa Gjon Pali II" nr. 3, Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS

Lagja Nr. 12, Rruga "Mujo Ulqinaku", te Shkolla "Marie Kaçulini", Durrës

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER ✓

Lagja "Kastriot", Rruga "Leon Rei", Fier

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, KORÇË

Rruga "Dhimitër Denasi", Korçë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, LEZHË

Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lezhë

Në zbatim të germës "dh" të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri është përgjegjës për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit parauniversitar, ku në zbatim të kësaj germe ka kompetencën për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurat e regjistrimit të nxënësve në institucionet arsimore. Në referim të këtij parashikimi kërkoj që për vitin shkollor 2023-2024, të merren të gjitha masat e nevojshme nga institucionet tuaja për realizimin e procedurës së regjistrimit të nxënësve në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.

Në vijim për realizimin e kësaj procedure, kërkojmë bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për rihapjen e sistemit *e-albania* për regjistrimin e nxënësve në periudhën 21.08.2023 deri më datë 01.09.2023, si dhe të mundësojë depozitimin e dokumentacionit ligjor për regjistrim në *e-albania* (vendime

gjqësore për kujdestari, kontrata qiraje për banim, etj. dokumente që legjitimojnë kërkesën e përfaqësuesit ligjor të nxënësit për regjistrimin e tij jashtë adresës së banimit), nga përfaqësuesit ligjor të nxënësve, për regjistrimin e tyre. Kjo kërkesë bëhet në mënyrë që të krijohet mundësia për regjistrimin e nxënësve, për të përmbushur të drejtën e tyre për arsim të parashikuar edhe në nenin 57, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Nga ana e institucioneve të arsimit parauniversitar kërkoj që të vijohet regjistrimi me prioritet brenda afatit të mësipërm. Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar të marrin masat e nevojshme për vlerësimin e aplikimeve dhe kthimin e përgjigjeve për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, brenda afateve në mënyrë që të krijohet mundësia e regjistrimit të të gjithë nxënësve. Në rast se institucionet e arsimit parauniversitar, kanë kapacitete për regjistrimin e nxënësve dhe jashtë zonës së banimit, të regjistrohen dhe nxënës jashtë zonës së banimit, pas miratimit nga ZVAP-të përkatëse mbi bazën e arsyeve të legjitimuara, si dhe këto regjistrime të pasqyrohen nga AKSHI në sistemin *e-albania*. Procesi i regjistrimeve të përfundojë për të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar brenda datës 01.09.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR

EVIS KUSHI

